



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

---

**AD-GJTHPZ.nr.14/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit N.L., nga Prizreni, respektivisht të përfaqësuesit të tij av.Xh.E., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit Sh.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.2461/21, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.1 I I I .2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankuesit N.L., nga Prizreni, respektivisht të përfaqësuesit të tij av.Xh.E., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit Sh.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.2461/21.

### **A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankueses N.L., nga Prizreni, respektivisht përfaqësuesi i tij av.Xh.E., nga Prizreni me datë 03.10.2024 pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit Sh.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.2461/21.

Ankuesi av.Xh.E., në kërkesën e paraqitur nuk ka deklaruar asgjë konkrete lidhur me shkeljet e pretenduara disiplinore të kryera nga gjyqtari Sh.Sh., por vetëm i ka bashkëngjitur shkresat e lëndës civile për të cilat gjyqtari duhet të vendos në bazë të këtyre provave. Në kërkesë ka bashkëngjitur edhe kërkesën për përjashtim të parashtruar për herë të dytë për të cilën ka ankesë se nuk është vendosur.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarit Sh.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.2461/21 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim.

Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes.

Gjyqtari ne deklaratën e tij lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se padia lidhur me këtë lëndë në gjykatë është dorëzuar me datë 15.11.2021, me të cilën është kërkuar vërtetimi i pronësisë ne bazë të mbajtjes lidhur me ngastrën kadastrale 1 1469-0 ZK Prizren, ku është kërkuar edhe caktimi i masës Së përkohshme të sigurimit. Gjykata me aktvendimin C.nr.2461/2021 të datës 18.11.2021 ka caktuar masën e përkohshme te sigurimit ashtu që të paditurve I. dhe I.L., i është ndaluar shitja, tjetërsimi dhe çfarëdo veprimi tjetër i cili do të ngarkonte ngastrën kadastrale. Duke vepruar sipas kundërshtimit te autorizuarit të paditurve av.V.O., dhe pas mbajtjes Së shqyrtimeve gjykata me aktvendimin C.nr.2461/21 të datës 13.06.2022 ka anuluar aktvendimin me të cilin është caktuar masa e perkohshme dhe është refuzuar kërkesa Për caktimin e mases Së sigurimit.

Duke vepruar sipas ankesës se paditësit Gjykata Apelit më aktvendimin Ac.nr.627/2022 dt. 10.10.2022 e ka aprovuar ankesën dhe e ka kthyer lëndën ne ri shqyrtim. Gjykata më aktvendimin C.nr.2461/21 dt. 17.07.2023 ka ndërprerë procedurën per shkak të vdekjes se të paditurit I. L.. Duke vepruar sipas kërkesës Së paditësit me të cilën ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit gjykues Kryetarja e Gjykatës më aktvendimin IV.AGJ.nr.1/24-50 dt. 12.03.2024 ka refuzuar kërkesën Për përjashtim. Gjykata në bazë të aktvendimit procedural të dt.03.06.2024 e ka obliguar palen paditëse që ta rregullon padinë dhe kërkesë padinë, ashtu që në vend të Ismet L. të përfshihet Sh. L. ngase pjesa kontestuese evidentohet në emër të tij. Paditësi respektivisht i autorizuari i tij av.Xh.E., me parashtrësën e dt. 12.06.2024 e ka precizuar padinë dhe kërkesë padinë. Në shqyrtimin e dt. 16.07.2024 i autorizuari i paditësit av.Xh.E., kerkon sërish përjashtimin e gjyqtarit përkundër faktit që një kërkesë e tillë nuk është e lejueshme. Gjykata më aktvendimin C.nr.2461/21 dt. 18.09.2024 e ka hedh si të pa lejueshme kërkesën per përjashtimin e gjyqtarit Për shkak se një here është vendosur paraprakisht. I autorizuari i paditësit av.Xh.E., me date 08.10.2024 ka propozuar caktimin e masës se përkohshme të sigurimit me ndalimin e ndërtimeve, kështu që gjykata me aktvendimin C.nr.2461/21 të dates 09.10.2024 ka caktuar masën e përkohshme dhe të paditurit Sh. L. ia ka ndaluar punimet në ngastrat kadastrale kontestuese. Pas ekspeditimit të këtij aktvendimi palëve dhe organeve kompetente i padituri Sh. L. ka parashtruar kundërshtim. Nga të dhënat e cekura sikurse më larte gjyqtari i çështjes konsideron se nuk ka bërë kurrfarë shkelje të cilat do ti perkisnin natyrës disiplinore, por te gjitha veprimet e ndërmarra bazohen ne dispozita ligj ore. Pretendimi i palës paditëse se përkundër faktit se është dorëzuar padia në gjykatë me propozimin Për masë, pala e paditur e ka tjetërsuar ngastrën kadastrale kontestuese nr. 1 1469-0 ZK Prizren një pretendim i tillë është në tërësi i pa bazuar Për shkak se padia në gjykatë është dorëzuar më dt.15.11.2021, ku masa e perkohshme është caktuar më aktvendimin C.nr.2461/2021 dt. 18.11.2021, ndërsa kontrata noteriale mbi LRP.nr.7960 me te cilën ngastra kadastrale kontestuese 11469-1 nga I. L. i dhurohet Sh. (Ismet) L. është lidhur më dt.29.10.2021, pra para se të dorëzohet padia ne gjykatë. Gjithashtu, kërkesa e paditësit parashtruar nga i autorizuari i tij av.Xh.E., e Cila po trajtohet si kërkesë Për inicimin e procedures disiplinore në fakt është kërkesë Për përjashtimin e gjyqtarit e bërë dhe atë per Së dyti herë (dt. 16.07.2024) e Cila është hedhë si e palejuar, si do që te jetë kjo kërkesë në fakt nuk i plotëson kushtet ligjore nga neni 5 të Ligiit nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ngase e njëjta qartazi është e pa bazuar dhe jo serioze, andaj i propozon Kryetares që kërkesën ta hedh poshtë bazuar ne nenin 9 par.6 të këtij ligji.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari i çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.2461/21.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren — Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me datë 15.11.2021 është parashtruar padia e paditësit N.L., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Xh.E., nga Prizreni kundër të paditurve Sh. L., H. L. etj, të gjithë nga Prizreni, me Objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, e Cila është e evidentuar me shenjë C.nr.2461/21. Gjyqtari i çështjes me të pranuar lëndën me aktvendimin e datës 18.11.2021 ka caktuar masën e përkohshme të sigurisë në ngastrën e kontestuar. Pas paraqitjes së kundërshtimit nga ana e të autorizuarit të paditurve dhe pas mbajtjes së shqyrtimeve gjykata me aktvendimin e datës 13.06.2022 ka anuluar aktvendimin me të cilin është caktuar masa e përkohshme dhe është refuzuar kërkesa Për caktimin e masës së sigurimit. Ndaj këtij aktvendimi pala paditëse ka parashtruar ankesë, të cilën Gjykata Apelit më aktvendimin Ac.nr.627/2022 dt. 10.10.2022 e ka aprovuar ankesën dhe e ka kthyer lëndën në ri shqyrtim. Gjykata më aktvendimin e datës 17.07.2023 ka ndërprerë procedurën për shkak të vdekjes së të paditurit I. L.. Pala paditëse në këtë çështje me datë 13.10.2023 ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit gjykues, për të cilën Kryetarja e gjykatës me aktvendimin IV.AGJ.nr. 1/24-50 të datës 12.03.2024 ka vendosur duke refuzuar kërkesën Për përjashtim. Gjyqtari pas refuzimit të përjashtimit ka vazhduar me procedurën dhe ka caktuar edhe dy seanca me dt. 03.06.2024 dhe me dt. 16.07.2024 ku i autorizuarit i paditësit av. Xh.E., sërisht ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit. Një kërkesë e tillë nuk është e lejueshme sipas dispozitës së nenit 69 par.1 pika b e LPK-së, sipas të cilit "Nuk është e lejuar kërkesa Për përjashtimin e gjyqtarit: Për kërkesën Për të cilën është vendosur njëherë;" dhe par.2 i këtij neni "Kërkesën nga paragrafi I i këtij neni e hedhë poshtë gjyqtari që është duke proceduar çështjen. Andaj, gjyqtari i çështjes duke vepruar sipas dispozitës së lartcekur dhe me aktvendimin e datës 18.09.2024 e ka hedhur si të pa lejueshme kërkesën Për përjashtimin e gjyqtarit Për shkak se një herë është vendosur paraprakisht.

Pas kësaj i autorizuarit i paditësit av.Xh.E., me datë 08.10.2024 ka propozuar caktimin e masës së përkohshme të sigurimit me ndalimin e ndërtimeve, kështu që gjykata me aktvendimin C.nr.2461/21 të datës 09.10.2024 ka caktuar masën e përkohshme dhe të paditurit Sh. L. ia ka ndaluar punimet në ngastrat kadastrale kontestuese. Deri më tani në veprimet e gjyqtarit lidhur me këtë çështje kontestimore nuk janë vërejtur që të ketë Shkelje disiplinore sig pretendohet nga ana e palës paditëse. Gjyqtari deri më tani ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPK-së dhe praktikës së përgjithshme gjyqësore.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtari Sh.Sh., në veprimet e tij nuk ka pasur Shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e

gjykatës ose mund të dëmtojë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më Iartë, Autoriteti Kompetent - Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

## **GJYKATA THEMELORE Në PRIZREN**

**AD-GJTHPZ.nr.14/2024, me dt.11.11.2024**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.